



U R D H Ë R

Nr.181 , datë 26.12.2018

PËR

NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E PUNËS PËR TË BËRË FUNKSIONAL PAVIJONIN E DIASPORËS, NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për organizimin e punës për të bërë funksional pavijonin e veçantë për diasporën, në Muzeun Historik Kombëtar, në zbatim të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri përgjegjës për diasporën dhe të ketë në përbërje:
 - përfaqësues nga ministria për kulturën anëtar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme anëtar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin anëtar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për turizmin anëtar;
 - titullari i Agjencisë Kombëtare të Diasporës anëtar;
 - titullari i Muzeut Historik Kombëtar anëtar;
 - titullari i Bibliotekës Kombëtare anëtar;
 - përfaqësues i Akademisë së Shkencave anëtar.



3. Grupi ndërinstytucional duhet të mblidhet rregullisht nga ministri përgjegjës për diasporën, si dhe me iniciativën e përfaqësuesve të institucioneve të tjera.
4. Çdo institucion përgjegjës i përmendur në këtë urdhër do të angazhojë pranë grupit ndërinstytucional të punës specialistët e fushës për realizimin e qëllimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri.
5. Ngarkohen titullarët e institucioneve përgjegjëse që, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të caktojnë përfaqësuesit e tyre në grupin ndërinstytucional.
6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare për Diasporën, Biblioteka Kombëtare, Akademia e Shkencave dhe Muzeu Historik Kombëtar për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA